

<b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</b>	<b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</b>	<b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</b>
---	--	---

**ASC-09-0092**

Në padinë e

**Punëtorët e [REDACTED]  
Parashtruesi i ankesës [REDACTED]**

*Parashtruesi i  
ankesës/Apeluesi*

Lubeniq, Pejë (aktualisht me banim në Gjermani)  
Përfaqësues: Luan Fetaj (Rr. Kodra e Diellit, H1, K6, B14,  
Prishtinë)

kundër

**Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)**  
adresa: Rr. Ilir Konushevci Nr.8, Prishtinë

*I Padituri*

### **Për: Ankuesin, të Paditurin**

Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), Kolegji i Ankesave, i përbërë nga Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 4 shkurt 2010 lëshon këtë:

### **AKTVENDIM**

**Apelimi refuzohet si i pabazuar.**

**Vërtetohet Aktvendimi i Trupit Gjykues të DHPGJS-së në lëndën SCEL-09-0015 C27 (datë 15 tetor 2009) me të cilin refuzohet anesa si e papranueshme.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Më 21 gusht 2009, Apeluesi ushtroi ankesë pranë DHPGJS-së ku kërkonte përfshirjen e babait të tij të ndjerë [REDACTED] në listën e punëtorëve me të drejta legjitime të NSH UTVA. Anesa ishte regjistruar me numrin 27. Afati i fundit për të ushtruar ankesë lidhur me listën e punëtorëve me të drejta legjitime të NSH UTVA së ishte publikuar nga AKP-ja ishte më 4 korrik 2009.

Apeluesi pohoi se i babai i tij i ndjerë kishte qenë punëtor i NSH UTVA nga data 1 shkurt 1983 deri më 1 prill 1999. Në bazë të dokumenteve të dorëzuara [REDACTED] kishte vdekur gjatë konfliktit të armatosur në vitin 1999. Apeluesi pretendoi se vdekja e babait të tij duhet të konsiderohet si diskriminim direkt,

kështu që babai i tij duhet të përfshihet në listën e punëtorëve me të drejta legjitime.

Më 1 shtator 2009, AKP-ja paraqiti reagimin e saj në ankesë. AKP-ja u pajtua me ankesën dhe – duke përmendur praktikën e mëparshme të DHPGJS-së – kërkoi përfshirjen e të ndjerit [REDACTED] në listën e punëtorëve me të drejta legjitime të NSH UTVA. Në reagimin e saj AKP-ja nuk e adresoi çështjen e pasafatshme të ankesës.

Më 15 tetor 2009, Trupi Gjykues i DHPGJS-së – mes tjerash – e refuzoi ankesën e Apeluesit si të papranueshme për faktin se ishte ushtruar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Aktvendimi i DHPGJS-së iu dërgua Apeluesit më 27 tetor 2009.

Më 25 nëntor 2009, Apeluesi ushtroi apelim me të cilin kërkoi anulimin e aktvendimit të DHPGJS-së SCEL-09-0015 C27 (i datës 15 tetor 2009) dhe të pranohet ankesa e tij si e afatshme. Ai pohon se nuk ishte në gjendje të ushtrojë ankesë para datës 14 gusht 2009, për faktin se pushimi i tij vjetor filloi mu atë ditë (vërtetuar nga punëdhënësi i tij në Gjermani). Apeluesi e ndryshoi pak ankesën tanë duke pohuar se babai i tij i nderë ishte punëtorë i NSH UTVA mes 1 shkurt 1983 dhe 23 shtator 1988.

### **Arsyet ligjore**

Apelimi është i pranueshëm por i pabazuar. Në bazë të nenit 63.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 Kolegji i Ankesave vendosi të refuzojë pjesën gojore të procedurës.

Apelimi mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse ankesa do të trajtohet si e afatshme. Nuk ka rëndësi nëse AKP-ja nuk e ka ngritur çështjen se ankesa ishte e pasafatshme, pasi që kjo është çështje e pranueshmërisë, e cila, parimisht, nuk është në zgjedhje të palëve, por duhet të merret parasysh ex officio.

Duke marrë parasysh këtë, Kolegji i Ankesave e konsideron ankimin si kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme në pajtim me nenin 117 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrتare e RSFJ 4/77, 36/80, 69/82, LPK).. Natyra ligjore e kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme është e natyrës procedurale dhe materiale, kështu që një pozicion i saktë i pranueshmërisë së një kërkeze të tillë është i panevojshëm. Megjithatë, kërkesa është e pabazuar.

Arsyet e justifikueshme në kuptim të nenit 117 paragrafi 1 i LPK-së (i cili është në fuqi për shkak të nenit 70 paragrafi 3 pika a e UA-së së UNMIK-ut 2008/6) për mosmarrjen e veprimeve të nevojshme procedurale në afatin kohor të paraparë me ligj apo të caktuar nga Gjykata jepen kur mosveprimi nuk ka qenë përfaj të palës që ka kërkuar kthimin në gjendjen e mëparshme. Fakti i pohuar se Apeluesi është dashur të qëndrojë në Gjermani deri më 14 gusht 2009 nuk është i pranueshëm si arsyë e tillë. Kjo jo vetëm që është në kundërshtim me deklarimet e mëparshme të Apeluesit se ai ishte në Kosovë deri më 25 korrik 2009. Së pari, Apeluesi mund të kishte autorizuar një avokat përfaqësuar atë para DHPGJS-së që do të siguronte që ankesa të dorëzohej në kohë. Më pastaj, në ankesën origjinale ai nuk kishte adresuar çështjen e vonesës dhe nuk kishte kërkuar, as absolutisht, kthimin në gjendjen e mëparshme.

Është detyrë e palëve që të vazhdojnë sa më parë me obligimet e tyre. Siç e përcakton neni 118 i LPK-së kthimi në gjendjen e mëparshme pas tre muajve nga dita e ometimit, nuk mund të kërcohët më. Afati prej tre muajsh ka skaduar më 5 tetor 2009.

Prandaj, kërkesa u hodh poshtë. Kjo u bë nga Kolegji i Ankesave në vend të Gjyqtarit Kryesues, siç parashihet me nenin 121 të LPK-së, pasi që dispozitat e LPK-së zbatohen vetëm me ato modifikime që konsiderohen të nevojshme nga DHPGJS-ja, neni 70 paragrafi 3 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6. Pasi që vendimi për të miratuar apo mohuar kthimin në gjendjen e mëparshme është vendim që prek mu në thelb të drejtën për gjykim të plotë të lëndës, Kolegji i Ankesave, duke marrë parasysh strukturën e procedurës para DHPGJS-së siç parashihet me UA-në e UNMIK-ut 2008/4 dhe UA-në e UNMIK-ut 2008/6, e konsideron të rëndësishme që këto vendime të merren nga Kolegji në vend të Gjyqtarit Kryesues.

Nuk është marrë vendim për shpenzimet.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues  
EULEX [nënshkruar]

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar  
EULEX [nënshkruar]

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare  
EULEX [nënshkruar]

Tobias Lapke, Regjistrues  
EULEX [nënshkruar]